



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2022:252931
Datë: 11.01.2024
Numri i dokumentit: 05178473

C-IV - 15 - 1745

Paditësi: I R nga Ferizaj, përfaqësuar nga avokati B I, nga Prishtina.

Kundër

Të paditurës: N. SH. „Pasuria Bujqësore” Prishtinë, e përfaqësuar nga Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP), Rr. “Driton Hoxha” nr. 55, Prishtinë.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, me gjyqtarin Hasim Sogojeva, me 04 janar 2024, mori këtë :

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET si e bazuar pjesërisht, ankesa/kërkesa e paditësit.**
- II. NDRYSHOHET Vendimi i Autoritetit Likuidues GJI 011- 0126, dt. 16.10.2013, ashtu që, obligohet e paditura NSH „Pasuria Bujqësore” që paditësit I R për dëmshpërblim për ndërprerje të parakohshme të marrëdhënies së punës, t’ ia paguaj për 5 (pesë) paga shumën 1,750.00€, kamatën 10% sipas shumës themelore dhe për shpenzime të procedurës shumën 124.00€, sipas nenit 40.1.6.2 të Shtojcës së Ligjit nr. 04/L-034.**
- III. REFUZOHET si e pa bazuar, pjesa tjetër e kërkesës mbi 5 (pesë) paga deri në 7 (shtat) paga ose mbi shumën 1,750.00€ deri në shumën e kërkuar 2,964.50€ dhe për shpenzime të procedurës, mbi shumën 124.00€.**

Rrethanat Faktike dhe Procedurale

Me dt. 14.11.2013, pranë DHPGJS, është parashtruar ankesa e grupit të punëtorëve, kundër të paditurit - Vendimit të Autoritetit të Likuidimit për NSH „Pasuria Bujqësore” me të cilin janë refuzuar kërkesat e punëtorëve për dëmshpërblim për ndërprerje të parakohshme të marrëdhënies së punës. Ky rast ka pasur shenjën C- IV- 13- 3128.

Me rastin e ndarjes së lëndes, rasti për paditësin ka marrë shenjën C- IV- 15- 1745. Më dt. 14.09.2015, paditësi ka dorëzuar parashtrësën përmes avokatit B I, që ka të bëjë me kundërshtimin e Vendimit për NSH „Pasuria Bujqësore” të AL GJI 011- 0126, dt. 16.10.2013

me të cilin është refuzuar kërkesa për dëmshpërblim për ndërprerje të parakohshme të marrëdhënies së punës, në shumën 2,964.50€.

Në parashtrësë i autorizuari është deklaruar se NSH „Pasuria Bujqësore”, është privatizuar më dt. 22.06.2009, dhe duke u bazuar në librezën e punës, paditësi kishte përvojë pune 46.39 vite, ky fakt nuk është kundërshtuar nga AKP-ja. Me rastin e refuzimit të kërkesës AKP-ja është bazuar në arsyen se deri te ndërprerja e marrëdhënies së punës nuk është bërë nga AKP-ja, përkatësisht nga një vendim i ndërmarr nga Agjencia dhe në bazën se kërkesa është parashkruar sipas nenit 608 të Ligjit të punës së bashkuar .

I autorizuari i paditësit pretendon se njoftimi për ndërprerje të marrëdhënies së punës nga Zyra Regjionale në Gjilan e AKP-së , ka ndodhur më dt.22.06.2009, dhe në tekst thuhet „Përfundimi i punësimit tuaj ka ardhur për si pasojë e shitjes së aseteve të NSH, pra si rezultat i ushtrimit të autorizimit të AKP-së, 6.2.1 të Ligjit nr. 04/L-034.

Meqenëse kontrata e punës nuk ju është ndërprerë asnjëherë paditësit deri në momentin e privatizimit të NSH , atëherë punëtorit i takon e drejta e dëmshpërblimit në përputhje me nenin 76 të Ligjit të punës.

Ka kundërshtuar edhe pretendimin e të paditurit se kërkesa është parashkruar. Kësaj parashtrëse nuk ja ka dorëzuar asnjë provë.

Më dt. 18.05.2023, Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme ka lëshuar Urdhër C- IV- 15- 1741, si për paditësin ashtu edhe për të paditurin.

Paditësit ju është kërkuar të dorëzon : një kopje të Vendimit të AL, kontratën e punës , dëshminë në lidhje me lartësinë e pagës mujore, dëshminë për përvojën e punës , ose Libreza e punës. Të paditurit ju është kërkuar të deklarohet në ankesë kundër Vendimit të AL GJI 011- 0126. Më dt. 31.05.2023, i autorizuari i paditësit ka dorëzuar parashtrësën me të cilën është deklaruar se mbetet pran argumenteve në padi fillestare. Në parashtrësë ka përsëritur pretendimet sipas parashtrësës dt. 14.09.2015 .

Ka kërkuar të miratohet, ankesa dhe të anulohet Vendimi i AL GJI 011- 0126, dt. 16.10.2013, për ndërprerje të parakohshme të marrëdhënies së punës të paguaj shumën 2,964.50€, ka kërkuar kamatën dhe shpenzimet e procedurës .

Me këtë parashtrësë ka dorëzuar :

- Kopjen e Librezës së punës,
- Vendimin e AL GJI 011- 0126,
- Letër pezullimi dt. 22.06.2009
- Lista e përfituesve nga 20 % , i të hyrave nga privatizimi,
- Kopjen e padis bazë.

Në rastin konkret, paditësi nuk ka dorëzuar si provë dëshmi të listës së pagave për vitin 2009, dhe lartësinë e pagës mujore .

Më dt. 08.06.2023 AKP-ja përmes përfaqësuesit të saj ka dorëzuar parashtrësën në mbrojtje ndaj ankesës së ushtruar kundër Vendimit të AL GJI 011- 0126, me propozim që ajo të refuzohet.

Në parashtrësë është deklaruar se NSH, ka hyrë në procedurë të likuidimit, më dt.19.06.2013, ndërsa më dt. 09.07.2013, parashtruesi i kërkesës ka ushtruar kërkesë për kompensim për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës, në shumën 2,964.50€.

Më dt. 14.10. 2013, AL mori Vendimin GJI 011- 0126, duke refuzuar kërkesën plotësisht. Vendimi i AL mbështetet në faktet dhe bazat ligjore në vijim:

- i. Neni 36.2 nën paragrafi 1, i Shtojcës së Ligjit nr. 04/L-034, parasheh „, elementet në vijim përbëjnë bazë të mirë dhe të mjaftueshme për refuzim të kërkesës apo interesit të pretenduar të kapitalit apo interesit të pronësisë... kërkesa ose pretendimi është i pasafatshëm nga kufizimet kohore të aplikueshme ”.
- ii. Neni 608 i Ligjit të punës së bashkuar parashikon „, pagesa e shumës së pagës apo rrogës ose të ndonjë kërkesë tjetër të punëtorëve që rrjedh nga marrëdhënia e punës parashkruhet për tre vjet ”

Në parashtrësë të mbrojtjes ka bashkangjitur :

- Kopjen e Vendimit GJI 011- 0126,
- Kopjen e Vendimit për emërimin e anëtareve të AL,
- Formularin e kërkesë kreditore,
- Kopjen e dokumentit identifikues,
- Letër pezullimin , dt. 22.06.2009,
- Kopjen e Librezës së punës,
- Lista e punëtorëve dt. 06.08.2013, e pa nënshkruar .

Arsyetimi Ligjor

Ankesa është e bazuar pjesërisht .

Në bazë të nenit 76.3 të Ligjit Nr.06/L-086 të DHPGJS në lidhje me nenin 398 të Ligjit mbi procedurën kontestimore, Gjykata nxjerrë këtë aktgjykim pa caktuar seancë dëgjimore.

Gjykata, ka shqyrtuar pretendimet e paditësit në ankesë dhe provat të cilat i ka bashkangjitur, sikundër edhe pretendimet e të paditurit, dhe ka konstatuar se paditësi ishte punëtor i të paditurës, sipas njoftimit dt. 22.06.2009 nga AKP-ja dhe Librezë të punës , e cila është e mbyllur, më dt. 22.06.2009 .

Për të paditurën si kontestuese është baza juridike e kërkesës për dëmshpërblim për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës, pasi sipas saj është parashkruar kërkesa .

Me Vendimin e Autoritetit të Likuidimit GJI 011- 0126, kërkesa e I R për dëmshpërblim për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës në shumën 2,964.50€, është refuzuar, duke u mbështetur në nenin 40.1.6.2 lidhur me nenin 36.2.1, të Shtojcës së Ligjit 04/L-034.

Në arsyetim të vendimit është konstatuar se bazuar në nenin 40.1.6.2, të Shtojcës së Ligjit nr. 04/L-034, me të cilën është paraparë mundësia e kompensimit për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës nëse punëtori është pushuar nga puna me veprimin e AKP- së, por bazuar në arkivin e NSH –së, më dt. 19. 06.2009, AL ka konstatuar se në kohën e privatizimit parashtruesi nuk ishte punëtor aktiv në NSH, ndryshe nga numri i punëtorëve që figurojnë në listë të pagave

në muajin janar të vitit 2009 , sikundër si arsye tjetër është sipas nenin 36.2.1 të Ligjit nr. 04/L-034, dhe nenin 608, të Ligjit për punën e bashkuar është parashkruar kërkesa e paditësit.

Për kundër këtij konstatimi në Vendim të AL, në parashtrësë të mbrojtjes dt. 08.06.2023, AKP-ja, është thirr, vetëm në parashkrim dhe nuk ka dorëzuar provën e listës së pagave të vitit 2009.

Gjykata vlerëson se në rastin konkret paditësi me provën e njoftimit „ Letër Pezullimi ” dt.22.06.2009, dhe provën e mbylljes së Librezës së punës, vërtetohet se deri te ndërprerja e marrëdhënies së punës ka ardhur me veprimin e AKP-së, ndërsa sipas Librezës së punës por edhe listës së 20 % , paditësi kishte stazh pune mbi 40 vite .

Me dispozitën e nenit 40 paragrafi 1. pika 1.6 .2, e Shtojcës së Ligjit nr. 04/L-034, është parapa „, kërkesat për dëmshpërblim për ndërprerje të parakohshme të kontratës të sjella nga punonjësit të cilat janë pushuar nga puna si rrjedhojë e Vendimit për Likuidim të ndërmarrjes, apo në lidhje me veprimin e ndërmarrë nga Agjencia sipas nenit 6.1 apo 6.2 të Ligjit për AKP-në ” .

Me nenin 31.5 të Ligjit nr. 06/L-086 është paraparë, „ Në rastin kur pala pohon të ekzistojë një fakt , ajo palë është e obliguar të paraqesë prova , fizike dhe ose dëshmuese për mbështetjen e atij pohimi ”

Çështja e dëmshpërblimit për ndërprerje të parakohshme të marrëdhënies së punës është e rregulluar edhe me Ligjin Themelor të Punës - Rregullorja 2001/27, si ligj në fuqi kur ka filluar procedura e likuidimit të NSH –së , me dispozitën e nenit 12, Shkëputja e kontratës së punës për shkak të ndryshimeve ekonomike , teknologjike ose strukturale në ndërmarrje, ashtu që sipas nenit 12, (dh - v), punëtorit me stazh pune mbi 30 vite i takojnë pesë paga mujore , e jo si ka pretenduar paditësi në formular të kërkesë kreditore, ndërsa në parashtrësë këtë fakt e ka heshtur i autorizuari i paditësit .

Gjykata palës paditëse dhe të paditur , ja dha mundësin që me Urdhër C- IV- 15-1745 , dt. 18.05. 2023, të dorëzojnë provat në mbështetje të pretendimeve, veçanërisht për vërtetimin e lartësisë së pagës mujore , por asnjëra palë nuk veproi .

Me provën e formularit të kërkesës kreditore, vërtetohet se paditësi ka kërkuar për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës shtat paga nga 350.00€, në shumën 2,964.50€. Kështu që nuk mungesë të provave, në rastin konkret barra e të provuarit bie mbi AKP-në, pasi ajo e ka arkivin dhe tërë dokumentacionin e NSH, gjykata e mori si të pranuar lartësinë e pagës mujore 350.00€.

Gjykata vlerëson se e paditura AKP/AL për NSH „ Pasuria Bujqësore ” si në Vendim ashtu edhe në mbrojtje nuk kanë argumentuar pretendimin se kërkesa është parashkruar, përkundrazi një pretendim i tillë është në kundërshtim me dokumentin e saj Letër pezullim, dt. 22.06.2009, dhe se në rastin konkret bazuar në këtë dokument parashkrimi rrjedhja e parashkrimit është pezulluar, pasi rrjedhja e procedurës së likuidimit në tërësi është varur nga AKP/AL .

Gjykata vlerëson se qëllimi i kompensimit të punëtorëve të cilëve ju ndërpritet kontrata e punës në mënyrë të parakohshme si pasojë e ndryshimeve strukturore në Ndërmarrje është e karakterit social që punëtori varësisht nga stazhi i punës të përfitojë disa paga dhe me to ta mbajë vetën dhe familjen derisa të gjen ndonjë vend tjetër pune dhe këtë periudhë ta ketë më lehtë ta tejkaloj situatën sociale të shkaktuar për shkak të ndërprerës së parakohshme të marrëdhënies së punës.

Gjykata vlerëson se paditësi i plotëson kriteret që të përfitoj nga dëmshpërblimi për shkak të ndërprerës së parakohshme të kontratës së punës sipas nenit 40 paragrafi 1, pika 1.6.2 e Shtojcës së ligjit lidhur me nenin 12 të Ligjit Themelore të Punës, për arsye se deri te ndërprerja e kontratës së punës, ka ardhur si pasojë e Vendimit të Bordit të AKP-së.

Me rastin e vërtetimit të kësaj gjendje faktike, Gjykata pjesërisht e aprovoi kërkesën e paditësit, duke ja pranuar për 5 (pesë) paga mujore, (350x 5= 1750) në shumën 1,750.00€, ndërsa ja refuzoi kërkesën mbi 5 (pesë) paga deri në 7 (shtat) paga mujore ose mbi shumën 1,750.00€ e deri në shumën e kërkuar 2,964.50€.

Në lidhje me kamatën, gjykata në shumën themelore, 1,750.00€, ja njohu paditësit kamatën 10%, duke zbatuar nenin 37.3, të Shtojcës së Ligjit nr. 04/L -034.

Meqenëse Gjykata, ka vërtetuar një gjendje tjetër faktike si më lartë në bazë të provave të dorëzuara nga palët ndërgjyqës dhe pretendimeve të tyre, nga ajo që është vërtetuar nga Autoriteti i Likuidimit me Vendim të ankimuar, Gjykata vendosi që Vendimi, GJI 011- 0126 të ndryshohet dhe ta pranoi pjesërisht ankesën/ kërkesën, duke vendosur si në dispozitiv.

Prandaj bazuar në vërtetimin e kësaj gjendje faktike dhe në pajtim me dispozitën e nenit 54.1 lidhur me nenin 74 të Ligjit nr. 06/L- 086 për Dhomën e Posaçme u vendos si në dispozitiv.

Shpenzimet Gjyqësore:

Në bazë të nenit 63 të Ligjit për Dhomën e Posaçme vendosi që paditësit t'ia pranoi shpenzimet e procedurës në shumën 124.00€, dhe atë : 104.00€, për parashtrësë të ankesës dhe 20 .00€, për taks gjyqësore, pjesa tjetër është refuzuar .

Këshillë Juridike:

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditësh nga pranimi i këtij aktgjykimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9 paragrafi 6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

Hasim Sogojeva
Gjyqtar